



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo
Nr.Bz.No. 1814 Dt. 24.06.2021

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NË MES TË

ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS DHE INSTITUTIT PËR HULUMTIME DHE TRAJNIME NË SHKENCAT MJEKËSORE “REZONANCA”

Neni 1

Oda e Stomatologëve të Kosovës dhe Instituti për Hulumtime dhe Trajnine në Shkencat Mjekësore “Rezonanca” (në vazhdim *Palët*) shprehin vullnetin dhe mirëkuptimin e tyre për bashkëpunimin në fushën e hulumtimeve shkencore në mjekësinë dentare, promovimin e shëndetit oral, konsulencave profesionale, trajnimeve dhe edukimit të vazhdueshëm profesional (EVP).

Neni 2

Kjo marrëveshje lidhet si shprehje e gatishmërisë për bashkëpunim dhe vullnet të mirë të *Palëve*, me mirëbesim dhe përpos përbashkët së zotimeve nga marrëveshja (fushave të bashkëpunimit), palët nuk kanë asnjë detyrim tjetër ndaj njëri tjetrit.

Neni 3

Palët dakordohen të mbështesin organizimin e aktiviteteve profesionale e shkencore të përbashkëta në fushën e EVP, si: ligjérata, kongrese/konferenca, tubime shkencore, seminare, simpoziume, trajnime dhe forma tjera të aktiviteteve me qëllim të ngritisjes profesionale të stomatologëve në nivel vendi.

Neni 4

Oda e Stomatologëve të Kosovës merr angazhimin për të njojur dhe për të akredituar format e ndryshme të aktiviteteve në kuadër të EVP-së që Instituti për Hulumtime dhe Trajnine në Shkencat Mjekësore “Rezonanca” organizon dhe është bartës i tyre.

Neni 5

Palët zotohen që me marrëveshje të ndërsjellët t'i ndajnë detyrat dhe obligimet e përgjithshme në rastet kur organizimi i aktiviteteve profesionale e shkencore në kuadër të EVP-së është i përbashkët, Ndarja e shpenzimeve për organizimin e aktiviteteve profesionale e shkencore (ku përfshihen sallat, ligjeruesit e ftuar, drekat dhe darkat për ligjerues të ftuar dhe mysfir të ftuar, tj.) bëhet sipas marrëveshjes paraprake.

Neni 5

Marrëveshja ka kohëzgjatje për një (1) vit. Palët mund ta vazhdojnë këtë marrëveshje me vullnet të dyanshëm duke përcaktuar objektiva të tjera për vitet vijuese.

Neni 6

Marrëveshja hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga të dyja palët.

Marrëveshja mund të përfundojë më iniciativën e cilësdo palë me paralajmërim prej 2 muajsh.

Neni 7

Kjo marrëveshje është bërë në gjuhën shqipe dhe atë në 2 (dy) ekzemplar identik, nga 1 (një) për secilën palë.

Prishtinë, 22.02.2021:

Për Odën e Stomatologëve të Kosovës

Prof .Dr. Blerim Kamberi
Kryetar



Për Institutin për Hulumtime dhe Trajnine
në Shkencat Mjekësore "Rezonanca"

Z. Eqrem Gara
Kryesues

